



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 02, datë 07.03.2016

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “KOMPLEKS TURISTIK
“PRESTIGE HOLIDAY RESORT”, ME VENDNDODHJE NË GOLEM, BASHKIA
KAVAJË”


Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me subjekt kërkues shoqërinë “Erjoni” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Kompleks Turistik “Prestige Holiday Resort”, me vendndodhje në Golem, Bashkia Kavajë”, me subjekt kërkues shoqërinë “Erjoni” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumentet e Lejes së Ndërtimit do t'i jepen subjektit kërkues, për secilën nga fazat të përcaktuara në hartën bashkëlidhur, vetëm pas:
 - plotësimit e dokumentacionit teknik dhe ligjor;
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOGA



DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT